



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 105, Datë 22.04.2021

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A., PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 343 SERIA F16 PËR FURNIZIMIN E ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe nenit 110, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “f”; nenit 5 pika 1, germa “f”; nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 109, datë 29.06.2016 e ndryshuar dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullores për Organizimin Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 47/7, datë 14.04.2021, mbi kërkesën e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 540 prot., 09.04.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës, sipas Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., në fazën e fillimit të procedurës, në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton kryesisht i plotësuar si më poshtë:
 - Delegimi i të drejtave të Aplikuesit, (neni 7, pika 2, germa “a”). **Plotësuar.**
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike neni 4.7, gjerat “a”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Nenin 7, “Delegimi i të drejtave të Aplikuesit”, pika 2:

- **germa “b”** Vërtetim që përfaqësuesi dhe i përfaqësuari nuk janë të përfshirë në një proces të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

Dokumentat juridike, administrative dhe pronësore

Neni 9, pika 2:

- **germa “d”** (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata).

Neni 16, pika 1, germa “c”

Dokumentat financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3

- **germa “c”** (Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.)

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

Neni 9, pika 4.7:

- **germa “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). **Duke qenë se sa thënë nga shoqëria, mbetet në kuadrin e deklaratës, në vijim do t’i kërkohet të paraqesë në ERE vërtetim për gjendjen e llogarisë nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj si dhe kapitalin financiar të shprehur në vlera monetare që do të verë në dispozicion të kësaj veprimtarie,**

Shoqëria do të njoftohet që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, Seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI